



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Rexha” Sh.P.K. të datës 21.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 16.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore” me nr. të prokurimit 616-23-14005-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Rexha” Sh.P.K. e datës 21.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 16.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore” me nr. të prokurimit 616-23-14005-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Rexha” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Rexha” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 21.02.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 16.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore” me nr. të prokurimit 616-23-14005-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se grupi i operatorëve ekonomik “Rexha & Termomontimi & Haxha Kom & 100% Design” përmes anëtarit të saj “Haxha Kom” Sh.P.K. ka dërguar një njoftim me shkrim për tërheqje nga kërkesa për rishqyrtim e cituar si më sipër.

Për këto arsye kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.


Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.02.2024

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.